

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6710
E martë, 20 shtator 2022
çmimi 0.40 €

Britania vlerëson
shërbimin e
Mbretëreshës në ditën
e varrimit të saj | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RRETH 320 000 NXËNËS NË GJITHË KOSOVËN TASH E TRI JAVË NUK JANË
DUKE E ZHVILLUAR PROCESIN MËSIMOR | FAQE 4-5

GREVA VAZHDON, QEVERIA HESHT, OPOZITA KËRKON ZGJIDHJE



Avokati i Popullit ka kërkuar reflektim nga palët për ndërprerjen e grevës në arsim, qeveria Kurti vazhdon të heshtë ndaj kësaj situatë, ndërkaq partitë opozitare të hënën sërish kanë kërkuar nga kryeministri Kurti të

gjejë një zgjidhje për ta ndërprerë grevën në arsim. Sipas partive opozitare, "refuzimi i qeverisë për dialog po vazhdon t'i dëmtojë të gjithë, më së shumti nxënësit"

AKTUALE



AMBASADORI ROHDE: SHPRESOJ QË
SHUMË SHPEJT TË LIBERALIZOHEN
VIZAT PËR KOSOVËN | F.3

MINISTRIA E DREJTËSISË MOHON
PEZULLIMIN E MARRËVESHJES ME
DANIMARKËN PËR BURGJET | F.6

HAPET KAMPI VEROR
NDËRKOMBËTAR 2022 | F.7

EKONOMI



PDK-ja DEL ME PESË PROPOZIME
PËR DALJE NGA KRIZA EKONOMIKE | F.8

EDHE MBI 600 MIJË EURO BORXHE
TË MBLEDHURA NGA ATK-ja | F.8

SPORT



BALLKANI SHKËLOEN NDAJ
FERIZAJT | F.10



HILL: SHBA-ja
MBËSHTET
PËRPRJEKJET
E BE-SË PËR TË
ARRITUR ZGJIDHJE
NË DIALOGUN
KOSOVË - SERBI | FAQE 3



KURTI U 'INFORMUA NGA AKI'-ja
PËR PLANIN PËR ATENTAT NDAJ
TIJ NË VITIN 2021 | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Britania vlerëson shërbimin e Mbretëreshës në ditën e varrimit të saj

LONDËR, 19 SHTATOR - Në Kishën Uestminster të Londrës është mbajtur ceremonia fillestare e varrimit të Mbretëreshës britanike, Elizabeta II. Në këtë Kishë, në të kaluarën, ajo është martuar dhe është shpallur mbretëreshë. Në mesin e 2 000 të ftuarve kanë qenë liderë botërorë, përfshirë presidentin amerikan Joe Biden dhe qindra udhëheqës të tjerë shtetesh. Udhëheqësi i ceremonisë, David Hoyle, ka vlerësuar shërbimin e kryer nga Mbretëresha gjithë jetën e saj. Mbreti Charles III ka qëndruar mbrapa arkivolit të mbretëreshës së ndjerë. Ceremonia është përcjellë me muzikë kishtarë dhe lexim të Biblës. Kryepeshkopi i Kantburit, Justin Welby, e ka përfshirë në predikimin e tij shprehjen e përdorur nga Mbretëresha, “ne do të takohemi sërish”. Ajo e pati përdorur këtë shprehje në një adresim të rrallë para kombit, pas shpërthimit të

pandemisë së koronavirusit. “Dhimbja e kësaj dite - e ndjerë jo vetëm nga familja e mbretëreshës, por edhe nga i gjithë kombi, dhe vendet e tjera në botë - lind nga jeta dhe shërbimi i saj i bollshëm”. Ceremonia në këtë kishë ka përfunduar me dy minuta heshtje. Arkivoli i Mbretëreshës ka kryer të hënën një shëtitje të fundit në Londër para se të dërgohet në Kështjellën Windsor. Aty do të mbahet një shërbim me 800 persona. Në fund, Mbretëresha Elizabeta II do të varroset në një ceremoni private në faltoren e Shën Xhorxhit, pranë burrit të saj të ndjerë, Princit Philip. Britania nuk ka organizuar ceremoni të tilla varrimi që 60 vjet, përkatësisht që nga varrimi i ish-kryeministrit Winston Churchill. Mbretëresha Elizabeta II ka vdekur më 8 shtator në moshën 96-vjeçare në Kështjellën Balmoral të Skocisë. Ajo ka qenë në fron për 70 vjet më



shumë se çdo monark tjetër i Mbretërisë së Bashkuar. Fronin e ka trashëguar djali i saj i madh, Charles, i cili tani njihet me emrin Mbreti Charles III. Pallati Bakingam ka thënë se vetë

Mbretëresha Elizabeta II - sa ka qenë gjallë - ka shtuar detaje personale në planin për ceremoninë e varrimit të saj. Kisha e Uestminsterit, ku do të mbahet shërbesa fetare, është

vendi ku janë kurorëzuar mbretërit e mbretëreshat e Britanisë, përfshirë edhe Elizabeta II më 1953. Në këtë kishë ajo është martuar me Princin Philip më 1947.

Zelensky përmend fitoret në fushëbetejë, amerikanët paralajmërojnë rreziqe të reja

KIEV, 19 SHTATOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka përmendur “një seri fitoresh” në fushëbetejë kundër forcave pushtuese ruse por, gjithashtu, i është bashkuar ushtrisë perëndimore dhe zyrtarëve të tjerë amerikanë, të cilët kanë paralajmëruar rreziqe të reja. Presidenti amerikan Joe Biden tha se derisa ukrainasit “po mposhtin Rusinë”, ka ende shumë punë për të bërë. Gjenerali i ushtrisë amerikane Mark Milley, gjatë një vizite në Poloni, shprehu shqetësimet për atë se si mund të reagojë Moskë ndaj pengesave në këtë betejë, duke u kërkuar trupave amerikane në Evropë dhe



aleatëve që të jenë në “vigilentë dhe në gjendje të larta gatishmërie”. Më herët gjatë ditës, ushtria e

Ukrainës tha përmes “Telegram”-it se trupat e saj kishin vendosur një urë në lumin Oskil, në kundërofensivën e tyre

në rajonin verilindor të Harkivit, ku duket se këtë muaj kanë rimarrë mijëra kilometra territorë. Javën e kaluar Zelensky kishte deklaruar se Ukraina ka rikthyer mbi 6 000 kilometra katrorë të territorit të pushtuar nga forcat ruse. Guvernatori i Luhanskut, Serhiy Hayday, shkroi në “Telegram” se “rajoni i Luhanskut është i ardhshmi. Ç’okupimi nuk është larg”. “Radio Evropa e Lirë” nuk ka mundur t’i verifikojë në mënyrë të pavarur pretendimet në fushëbetejë në zonat ku lufta po zhvillohet intensivisht. Presidenti Biden tha, në një

paraqitje televizive, se “fitorja e luftës në Ukrainë do të thotë ta largosh Rusinë plotësisht nga Ukraina dhe të njohësh sovranitetin [ukrainas]”. Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës në shkallë të gjerë në fund të shkurtit. Konflikti është më i madhi në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. Kombet e Bashkuara kanë konfirmuar më shumë se 5 500 civilë të vrarë dhe mbi 6.6 milionë të zhvendosur, edhe pse numri i viktimeve besohet të jetë shumë më i lartë. Humbjet ushtarake janë, po ashtu, të mëdha, mbi 9 000 ukrainas të vrarë dhe mbi 25 000 rusë, sipas vlerësimeve të inteligjencës perëndimore.

Polonia dhe Baltiku ua ndalojnë hyrjen shumicës së qytetarëve rusë

VARSHAVË, 19 SHTATOR - Nga dita e hënë shumica e qytetarëve rusë nuk do të mund të hyjnë në territoret e Polonisë, Estonisë, Letonisë dhe Lituanisë. Shtetasit rusë me vizë Shengen, të cilët duan të lëvizin për qëllime turizmi, biznesi, sporti ose arsye kulturore, nuk do të mund të hyjnë në territoret e këtyre vendeve. Shtetet që ndajnë kufirin me Rusinë - vendet baltike, Polonia dhe Finlanda, kanë bërë thirrje të parat për masa

kufizuese në vizat turistike për rusët. Nga e njëjta ditë edhe Zvicra tha se do t’i pezullojë procedurat e thjeshtuara të vizave për rusët. Polonia dhe shtetet Baltike thanë se ndalimi nuk përfshinë disidentët politikë, rastet humanitare dhe një sërë rrethanash të tjera, duke përfshirë misionet diplomatike ruse dhe lidhjet familjare. Më 31 gusht BE-ja pezulloi marrëveshjen për viza me Rusinë si një “hap i parë i domosdoshëm”.

Për pasojë, rusët do ta kenë më të vështirë sigurimin e një vize dhe procesi do t’u kushtojë më shtrenjtë. Vendet e BE-së nuk kanë arritur të pajtohen për një ndalesë totale për vizat turistike për rusët, meqë vendet anëtare janë të ndara në këtë çështje. Gjermania dhe Franca kanë qenë në anën tjetër të debatit, duke thënë se kufizimi i vizave për rusët do të rezultojë si masë joproduktive, teksa BE-ja tenton të luftojë për “zemrat dhe mendjet” e atyre rusëve që



nuk përkrahin luftën në Ukrainë. Kievi i ka bërë thirrje BE-së ta

ndalojë lëshimin e vizave për të gjithë rusët, përveç disidentëve politikë.

Kurti u "informua nga AKI"-ja për planin për atentat ndaj tij në vitin 2021

Prishtinë, 19 shtator - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka qenë i informuar nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), se ka pasur një plan për atentat ndaj tij në vitin 2021. "Institucionet e sigurisë i kanë ndërmarrë të gjitha masat për parandalimin e këtij veprimi. Rasti nuk është bërë publik për të mos përhapur panik", thuhet në njoftimin e Zyrës së Kryeministrit Kurti. Në bazë të raportimeve të

medieve në Shqipëri, Njësia Kundër-Terrorizmit e Policisë së Kosovës kishte marrë informacione nga burime të inteligjencës për kërcënime për vrasjen e tre personave: Albin Kurti, Xhavit Haliti dhe Ismet Haxha.

Haliti, deputet i subjektit opozitar Partisë Demokratike të Kosovës, ka konfirmuar për mediet lokale në Kosovë se ka pranuar informacione për kërcënime ndaj jetës së tij. Ndërkaq Ismet Haxha është

ish-pjesëtar i Shërbimit Informativ të Kosovës (ShIK). Vrasja e këtyre tri figurave ishte planifikuar me qëllim të, siç thuhet në dokumentin të cilit i referohen mediet në Shqipëri, "të destabilizimit të Kosovës".

Sipas raportimeve, Prek Kodra, shtetas i Shqipërisë, dyshohet se ka planifikuar vrasjen e tyre. Ai, po ashtu, sipas një dokumenti, ka qenë i dyshuar për përfshirje në disa vrasje në Kosovë dhe Mal të Zi.



Hill: ShBA-ja mbështet përpjekjet e BE-së për të arritur zgjidhje në dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Ambasadori amerikan në Serbi, Christopher Hill, ka deklaruar se ShBA-ja mbështet Bashkimin Evropian në përpjekjet për të arritur një zgjidhje në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. "[Problemi] ka vazhduar për një kohë shumë të gjatë dhe është koha për përparim", u tha Hill gazetarëve në Forumin Rajonal për Evropën dhe Euroazinë - EducationUSA në Beograd, transmeton "Beta".

Ambasadori amerikan nuk ka dashur ta komentojë planin e pretenduar për kornizën e re të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila është hartuar pas angazhimit të të dërguarve nga Gjermania dhe Franca. "Nuk më takon mua t'i komentoj

propozimet, përveçse të them se ShBA-ja mbështet BE-në, e cila po përpjeket shumë të gjejë një zgjidhje të pranueshme për të gjithë dhe kjo nuk është e lehtë", ka deklaruar Hill. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, tha më 10 shtator se diplomatët evropianë kanë propozuar "kornizë të re" për dialogun në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Përfaqësuesi special i BE-së për dialog, Miroslav Lajçak, në reagimin e tij, tha se është i befasuar nga njoftimet e tilla.

Në fillim të shtatorit Hill u ka thënë gazetarëve në Beograd se është inkurajues përparimi i arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë në 10 ditët e fundit.

Nën ndërmjetësim të Bashkimit Evropian, më 27 gusht, Serbia dhe

Kosova arritën marrëveshje për dokumentet për hyrje/dalje. Sipas saj, Kosova dhe Serbia janë pajtuar për t'i hequr dokumentet shtesë kur qytetarët të hyjnë në territorin e njëra-tjetrës.

Kosova dhe Serbia kanë marrëveshje për lëvizje të lirë prej vitit 2011.

Serbia e ka zbatuar atë menjëherë dhe për 11 vjet ua ka lëshuar qytetarëve të Kosovës këtë lloj dokumenti.

Kur Qeveria e Kosovës ka vendosur ta zbatojë këtë pikë të marrëveshjes më 1 gusht, serbët në veri të Kosovës kanë rritur tensionet përmes vendosjes së barrikadave.

Qeveria e Kosovës e ka shtyrë më pas zbatimin e vendimit për 1

shtator, mirëpo ndërkohë palët janë marrë vesh për moslëshimin e tyre. "Shpresoj se marrëveshjet do të vazhdojnë, siç ishte rasti me dokumentet personale dhe Kosova dhe Serbia të kenë një të ardhme shumë më të mirë", ka thënë Hill në atë kohë.

Ndërkohë, më 15 shtator, Kuvendi i Serbisë miratoi raportin për dialogun me Kosovën. "Raporti është i shkruar në 50 faqe dhe liston aktivitetet në kuadër të përgatitjes dhe realizimit të negociatave", përfshirë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, policinë, gjyqësorin, energjinë, odat ekonomike, transportin e mallrave të rrezikshme, si dhe të zhdukurit që gjenden në kapitullin e fundit.

Seanca ka zgjatur dy ditë dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, gjatë prezantimeve të tij ua ka përsëritur deputetëve se nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës.

I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, më 15 shtator zhvilloi takim me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe zëvendësin e tij, Besnik Bislimi. Ai tha se qëllim i vizitës së tij në Prishtinë është "çuarja përpara" e këtij procesi.

Lajçaku tha se në takim u bisedua për "vazhdimin e dialogut" dhe për takimin e ardhshëm të Kurtit me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Kurti dhe Vuçiq u takuan për herë të fundit në Bruksel më 18 gusht.



Ambasadori Rohde: Shpresoj që shumë shpejt të liberalizohen vizat për Kosovën

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, ka thënë se shpreson që qytetarët e Kosovës shpejt të udhëtojnë pa viza.

Franca, Gjermania dhe Polonia kanë kërkuar përparim në rrugën e liberalizimit të vizave për Kosovën. "Shpresojmë që

shumë shpejt të liberalizohen vizat dhe ju të mund të udhëtoni pa viza. Ndoshta e keni parë deklaratën e shefave të shteteve Gjermani, Francë dhe Poloni të cilët kanë deklaruar se është koha për liberalizimin e vizave. Shpresojmë që shumë shpejt të merret ky vendim", ka thënë

ambasadori gjerman.

Këtë deklaratë ai e ka bërë gjatë hapjes së Kampit Veror nga Education Unlimited në Gjimnazin Loyola në Prizren, në të cilin do të marrin pjesë 80 nxënës nga Evropa.

Kosova është vendi i vetëm në rajon që nuk ka liberalizim të vizave.





RRETH 320 000 NXËNËS NË GJITHË KOSOVËN TASH E TRI JAVË NUK JANË DUKE E ZHVILLUAR PROCESIN MËSIMOR

Greva vazhdon, qeveria hesht, opozita kërkon zgjidhje

Avokati i Popullit ka kërkuar reflektim nga palët për ndërprerjen e grevës në arsim, qeveria Kurti vazhdon të heshtë ndaj kësaj situate, ndërkaq partitë opozitare të hënën sërish kanë kërkuar nga kryeministri Kurti të gjejë një zgjidhje për ta ndërprerë grevën në arsim. Sipas partive opozitare, “refuzimi i qeverisë për dialog po vazhdon t’i dëmtojë të gjithë, më së shumti nxënësit”

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Avokati i Popullit, Naim Qelaj, ka bërë me dije se ditët e fundit ka diskutuar me qeverinë dhe sindikatat për gjetjen e një zgjidhje dhe fillimin e procesit mësimor. Ai u ka bërë thirrje SBASHK-ut dhe Qeverisë së Kosovës që të reflektojnë dhe

të gjejnë një zgjidhje për ndërprerjen e grevës në arsim. Institucioni i Avokatit të Popullit në një komunikatë për medie ka theksuar se, pavarësisht prej takimeve, nuk është arritur një marrëveshje në mes palëve për ndërprerjen e grevës. “Avokati i Popullit ditët e fundit ka mbajtur takime të ndara me përfaqësues të

sindikatave dhe të qeverisë në përpjekje për të ndihmuar për dalje nga kjo situatë. Përkundër përpjekjeve të bëra nga ana e tij si ndërmjetësues, fatkeqësisht, nuk është arritur një marrëveshje mes palëve. Palët nuk kanë gjetur një konsensus. Ato kanë mbajtur qëndrimin e njëjtë kur vjen në pyetje lartësia financiare e pakos mbështetëse”, është

thënë në komunikatë.

Avokati i Popullit, Naim Qelaj, ua ka rikujtuar palëve se çdo qëndrim apo veprim, në qendër të çdo prioriteti duhet ta ketë interesin më të mirë të fëmijës dhe të drejtën e fëmijëve për edukim dhe arsimim si e drejtë e garantuar me Kushtetutë. “Parimi i interesit më të mirë për fëmijët duhet ta udhëheqë secilin prej nesh në kuadër të përmbushjes së detyrimeve dhe të përgjegjësive që kemi”, ka pohuar ai.

Avokati i Popullit rikujton përgjegjësinë kushtetuese e ligjore të qeverisë dhe

detyrimin pozitiv që ka shteti për respektimin e së drejtës për arsimim dhe respektim të të drejtave dhe të lirive të njeriut, siç janë të përcaktuara në Kushtetutë.

Edhe të hënën partitë opozitare i kanë bërë thirrje kryeministrit Kurti që të gjejë një zgjidhje për ta ndërprerë grevën në arsim.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se mbi 300 mijë nxënës po vazhdojnë të qëndrojnë në shtëpi edhe sot e do të duhej të ishin në shkollë që gati tri javë. “Refuzimi i qeverisë për

Sveçla, thirrje Vuçiqit: Ndaloni aktet e dhunshme dhe terroriste ndaj qytetarëve të Kosovës

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Ministri i Brendshëm, Xhelal Sveçla, ka thënë se po vazhdon ndjekja dhe kërcënimi i qytetarëve serbë që po pranojnë simbolet legale të shtetit të Kosovës. Në “Twitter” ai ka njoftuar se gjatë ditës së sotme një tjetër pjesëtar serb i Policisë së Kosovës është kërcënuar, me ç’rast i është djegur makina

vetëm pse ajo kishte targa RKS. Ai i ka bërë thirrje presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiqi, që të ndalojë së përkrahuri veprimet e dhunshme që ushtrohen ndaj qytetarëve që i qëndrojnë besnik shtetit të Kosovës. “Tendencat për të ndjellë frikë vazhdojnë. Sot një tjetër oficer serb i Policisë së Kosovës është sulmuar nga

strukturat ilegale, të cilat dogjën veturën e tij me targa legale RKS. Kjo është një thirrje e hapur për t’u luftuar institucionet e Republikës së Kosovës. I kërkojmë Vuçiqit të ndalojë së përkrahuri veprimet e dhunshme dhe terroriste ndaj qytetarëve besnikë të Republikës së Kosovës”, thuhet në postimin e Sveçlës.



Osmani takon Mbretin Charles III dhe kryeministren Truss

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka marrë pjesë në ceremoninë e varrimit të Mbretëreshës Elizabeth II në

Londër. Në këtë ceremoni Osmani ka takuar Mbretin Charles III dhe kryeministren e Mbretërisë së Bashkuar, Liz Truss.

Osmani ka shkruar se Mbretëresha Elizabeth II do të mbahet mend si simbol i forcës. "Mbretëresha do të mbahet mend si një simbol i forcës dhe

qëndrueshmërisë dhe për angazhimin e palëkundur ndaj shërbimit publik", ka shkruar Osmani. Rreth 2 000 të ftuar, përfshirë

disa qindra presidentë, krerë shtetesh dhe monarkë, të hënë kanë marrë pjesë në funeralin e Mbretëreshës Elizabeth II në Westminster Abbey në Londër.



dialog po vazhdon t'i dëmtojë të gjithë, më së shumti nxënësit. Nga 1 shtatori jeta e prindërve dhe mësimdhënësve është vështirësuar edhe më tej. Kjo bllokadë, që po ndodh si pasojë e kokëfortësisë së qeverisë, kërkon zgjidhje urgjente. Mësimdhënësit nuk po kërkojnë pazare e as lëmoshë, por vetëm dinjitet. Dinjiteti është boshti i veprimtarisë së tyre historike dhe qeveria nuk duhet t'ua mohojë këtë vlerë. Janë po këta njerëz që edhe në periudha më të vështira kanë ruajtur dinjitetin tonë njerëzor dhe kombëtar. Duhet

t'i mirëkuptojmë, sepse janë prindërit tanë të dytë. Kryeministër, për hir të fëmijëve, gjej zgjidhje!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Kryetarja e Forumit e Gruas e LDK-së, Jehona Lushaku, ka thënë se shtyrja e fillimit të vitit shkollor po i dëmton nxënësit dhe prindërit. Ajo ka kërkuar nga qeveria që të gjejë zgjidhje të menjëhershme. Lushaku në një konferencë për medie ka theksuar se mbi 1 040 shkolla dhe 318 000 nxënës në gjithë Kosovën tash e tri javë nuk janë duke e zhvilluar procesin mësimor, e gjithë kjo si pasojë e

arrogancës së pushtetit i cili, në vend se të dialogojë, po vazhdon me polarizim të skajshëm shoqëror duke privuar nxënësit nga mësimi. Lushaku i bëri thirrje qeverisë që në mënyrë urgjente ta fillojë dialogun duke gjetur zgjidhje të menjëhershme, që procesi mësimor të fillojë sa më parë. "Kjo krizë e krijuar është duke pasur ndikim enorm ekonomik te familjet, pasi që prindërit janë duke rrezikuar vendet e tyre të punës. Qeveria duhet ta ketë ndjeshmërinë e përgjegjësinë e duhur që fëmijët të kthehen në bankat shkollore menjëherë e prindërit t'i

kthehen punës dhe funksionimit të rregullt", ka thënë ajo.

Ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, e ka akuzuar SBASHK-un se po refuzon bashkëpunimin me qeverinë dhe ndërmjetësit për të gjetur një zgjidhje për grevën në arsim. Ajo ka treguar se bashkë me zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi dhe ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, janë takuar të shtunën me Avokatin e Popullit për të diskutuar për grevën në arsim.

Nagavci në "Facebook" ka

theksuar se kanë shprehur gatishmërinë për ta vazhduar dialogun dhe fillimin e procesit mësimor njëkohësisht. E para e Arsimit thotë se si pasojë e atij takimi kanë pranuar një letër nga Avokati i Popullit, Naim Qelaj, të cilën e kanë shqyrtuar dhe menjëherë i kanë kthyer përgjigje, duke adresuar propozimet e tij. "Si qeveri kemi pritur që të ketë gatishmëri edhe nga SBASHK-u dhe ta vazhdojmë dialogun social e të fillojë mësimi. Por, përmes medieve kemi parë tashmë që Sindikata ka dalë me qëndrim se greva vazhdon", ka shkruar Nagavci.

Prokuroria e Pejës ndalon tre persona për vjedhjen e 20 mijë eurove

PEJË, 19 SHTATOR - Prokuroria Themelore në Pejë ka njoftuar se ka ndaluar tre persona (H. A., E. H., dhe M. A.) të cilët, duke vepruar si anëtarë të grupit, kanë kryer veprën penale "Vjedhje e rëndë" nga neni 315 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Tre të dyshuarit kanë arritur ta vjedhin nga i dëmtuari

shumën e parave në vlerë prej njëzet mijë (20 000.00) mijë eurosh por, pas koordinimit të Prokurorit të Shtetit me Policinë e Kosovës, tre të dyshuarit janë arrestuar mbrëmë rreth orës 18:00.

Pas kontrollit të shtëpive të të pandehurve, në shtëpinë e njërit prej të dyshuarve janë gjetur të gjitha paratë e

vjedhura.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit të dyshuarit janë ndaluar 48 orë, ndërsa brenda afatit ligjor Prokuroria Themelore në Pejë do të paraqesë kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit ndaj tre të pandehurve në gjykatën kompetente.



Tri shoqata të veteranëve bëhen bashkë kundër vizitës së Trendafilovës

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, së bashku me Qëndron Kastratin, kanë takuar udhëheqësit e Shoqatës së Veteranëve të Gjilanit, të Kamenicës dhe të

Vitisë, të cilëve u kanë ofruar mbështetje për protestën e së mërkurës në Gjilan.

Molliqaj ka thënë se Gjykata Speciale është e padrejtë qysh në fillim. "Ajo e ka shkelur

kriterin e barazisë mes palëve dhe të drejtat e njeriut. Vizitat për matje të opinionit publik dhe rregullim të imazhit të saj me takime të mbyllura janë të padëshirueshme. Prandaj, të

mërkurën, nga ora 10:00, 'Hotel Astoria', Gjilan, do të zhvillohet takimi i znj. Trendafilova. Protestojmë kundër kësaj vizite!", ka thënë Molliqaj.



Ministria e Drejtësisë mohon pezullimin e marrëveshjes me Danimarkën për burgjet

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Ministria e Drejtësisë në Kosovë tha se marrëveshja me Danimarkën për të sjellë në Kosovë 300 të burgosur është ende në fuqi. Ky reagim i MD-së vjen pasi më 19 shtator u raportua se Danimarka kishte pezulluar marrëveshjen me Kosovën, të nënshkruar më herët gjatë këtij viti.

MD tha se "kemi marrë konfirmimin se bëhet fjalë për një keqkuptim nga një media lokale e atjeshme dhe pritet që kjo gjë të sqarohet tutje". Më 27 prill Kosova dhe Danimarka u pajtuan që të sillen në Kosovë 300 të burgosur si pjesë e përpjekjeve të Danimarkës për ta reduktuar mbipopullimin në burgjet e saj.

Fillimisht, në dhjetorin e vitit të kaluar dy shtetet u pajtuan që të merren me qira 300 qeli burgu në këmbim të një tarife vjetore prej 15 milionë eurosh. Marrëveshja ka një kohëzgjatje prej dhjetë vjetësh dhe Kosova pritet të përfitojë 210 milionë euro.

Të burgosurit e huaj, sipas marrëveshjes, do të dërgohen

në fillim të vitit 2023 në një burg në qytetin e Gjilanit.

Pas vuajtjes së dënimit, ata do të dëbohen nga Kosova.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes me Kosovën, ministri i Drejtësisë i Danimarkës, Nick Haekkerup, tha se pakti dërgon sinjal të qartë për të huajt "nga vendet e palëve të treta që janë dënuar

me dëbim".

"E ardhmja juaj nuk është në Danimarkë dhe për këtë arsye nuk do ta kryeni dënimin tuaj këtu", tha ai.

Shteti i Danimarkës ka qëndrime të ashpra për emigracionin dhe dy shtete planifikojnë që ta transferojë menaxhimin e të huajve përtej kufijve të Bashkimit Evropian.



Vazhdon trajnimi për investime publike dhe për zhvillim dhe menaxhim të buxhetit

Prishtinë, 19 shtator - Qendra e Trajnimit e Asociacionit të Komunave të Kosovës javën e kaluar ka vazhduar serinë e trajnimeve për komunat për ta avancuar përgatitjen dhe finalizimin e buxhetit komunal në programet "Programi për Investime Publike" dhe "Sistemi për Zhvillim dhe Menaxhim të Buxhetit".

Pjesë e këtyre trajnimeve kanë qenë zyrtarët komunalë të drejtorive për buxhet dhe financa, shëndetësisë dhe arsimit si dhe zyrtarët

kryesorë financiarë nga komunat e regjionet e Pejës, Prishtinës, Mitrovicës dhe Prizrenit.

Trajnimit është mirëpritur nga pjesëmarrësit i cili ka ofruar ndihmë dhe udhëzime praktike në fushën e zhvillimit e menaxhimit të buxheteve komunale duke ndërlidhur me investimet publike në nivelin lokal. Këto trajnime do të vazhdojnë gjatë javës edhe në komunën Shtërpçë, Graçanicë, Kllokot, Partesh, Ranillugë e Novobërdë.



Konjufca pret koordinatoren e OKB-së, thellojnë bashkëpunimin e ndërsjellë

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të hënën në takim koordinatoren e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Kosovë (UNKT), Arnhild Spence. Konjufca i shprehu mirënjohje Spences për punën e misionit të Kombeve të Bashkuara, me

fokus të veçantë në mbështetjen e përpunimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë.

Ai, gjithashtu, e njoftoi koordinatoren e OKB-së me arritjet e deritashme, detyrat, objektivat dhe synimet e kësaj legjislature të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konjufca dhe Spence konfirmuan gatishmërinë e thellimit të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe sa më efektiv për konsolidimin e demokracisë, zhvillimin e qëndrueshëm, mirëqenien e qytetarëve dhe mbështetjen e reformave integrale.



Edhe mbi 600 mijë euro borxhe të mbledhura nga ATK-ja

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Angazhimi i pandërprerë i Departamentit të Mbledhjes së Detyrueshme për trajtimin e borxheve të tatimpaguesve ndaj Administratës Tatimore të Kosovës ka rezultuar me mbi 600 mijë euro të mbledhura. Aksioni në fjalë është realizuar te 18 subjekte

biznesore. "Stafi i Mbledhjes së Detyrueshme mbetet i përkushtuar maksimalisht për trajtimin dhe mbledhjen e borxheve, duke ndërmarrë të gjitha procedurat e mbledhjes së detyrueshme, deri te konfiskimi i pasurisë dhe kallëzimi penal, për të gjithë ata tatimpagues që nuk i kryejnë obligimet

tatimore, të cilat dalin nga Legjislacioni Tatimor. Kujtojmë se në periudhën e fundit janë ndërmarrë aktivitete të shumta për mbledhjen e borxheve, me theks të veçantë konfiskimi i pasurisë, që për herë të parë ka rezultuar në uljen e stokut të borxheve", ka njoftuar ATK-ja.



Hapet kampi veror ndërkombëtar 2022

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Në prani të nxënësve nga Kosova, Shqipëria, Gjermania, Franca dhe Maqedonia e Veriut, dhe ligjërues nga e gjithë Evropa, kryeministri Albin Kurti mori pjesë në hapjen e Kampit Veror Ndërkombëtar 2022.

Edu Kamp 2022 organizohet nga shoqata gjermane Education Unlimited, e bashkëfinancuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit e Republikës së

Kosovës dhe ndihmuar nga gjimnazi Loyola. "Ky kamp veror, për 83 të rinj nga 5 vende të ndryshme, është mundësuar sepse të gjithë ne që jemi sot këtu, e njohim dhe e çmojmë vlerën e një shoqërie të arsimuar mirë", ka theksuar kryeministri Kurti.

Ai theksoi se të gjithë besojnë se çdo njeri duhet t'i ketë të drejtat e njëjta, ndërsa kryeministri thotë se qeveria angazhohet me punë, që në shoqërinë tonë të gjithë t'i kenë edhe mundësitë e njëjta. Kryeministri potencoi se për këtë synim Qeveria e Kosovës ka rritur

buxhetin për arsim për 12%. "Ka bërë arsimin publik falas për nivelin baçelor dhe master. Ka ndarë mbi 3 000 bursa për studentët e dalluar për studime brenda dhe jashtë vendit. Për mbyllje të hendekut gjinor janë ndarë 1 365 bursa për vajzat dhe gratë studente të fushave STEM. 106 bursa për nxitjen e vajzave për të ndjekur profile teknike dhe nxitjen e djemve për të ndjekur profile deficitare", ka thënë ai.

Kurti ka bërë me dije se janë ndarë 957 kuponë për maturanët të shkollave profesionale për të ndjekur kurse të teknologjisë së

informacionit. "E tekste shkollore në gjuhët e të gjitha komuniteteve që jetojnë në vendin tonë: 150 000 euro për bursa për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian; 3 500 000 euro për ofrimin e praktikës profesionale për nxënësit e shkollave të arsimit dhe aftësisimit profesional. Për ta mbyllur hendekun e shkathtësive, ka filluar pilotimi i arsimit dual në katër profile nga viti shkollor 2022/2023, për muratorë, floktarë, asistentë të hotelierisë dhe kuzhinier; Për herë të parë kemi ndarë buxhet për mësimdhënësit me probleme

shëndetësore - 1.7 milion euro, nga të cilat përfitojnë rreth 300 mësimdhënës", ka deklaruar Kurti. Ai ka shtuar se për herë të parë kanë filluar zbatimin e skemës për mësimdhënie të bazuar në hulumtim, si formë e nxitjes së punës shkencore-hulumtuese edhe në mësimdhënie në arsimin e lartë. Duke uruar për organizimin e këtij kampi veror dhe duke u dëshiruar mbarësi, kryeministri e përmbylli fjalimin duke theksuar se dashuria për dijen dhe shkencën do të thotë dashuri për njerëzimin dhe zhvillimin.



Të enjten Kuvendi mbledhet në seancë plenare

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Mbledhja e Kryesisë e Kuvendit të Kosovës, e paraparë për të hënë, nuk kishte kuorum të mjaftueshëm, megjithatë

kryetari Glauk Konjufca, në bazë të kompetencave të tij dhe në koordinim me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, vendosi që të

enjten, më 22 shtator, Kuvendi të mbledhet në seancë plenare. Kështu, të enjten, me fillim nga ora 11:00, Kuvendi do t'i vazhdojë punimet me pikat e

papërfunduara nga seanca plenare e mbajtur më 15 shtator, për të vijuar me pikat e papërfunduara në seancën plenare të 4 gushtit.



Inaugurohet Sistemi Nacional për Monitorimin e Spektrit Frekuencor, projekt me rëndësi nacionale

MITROVICË, 19 SHTATOR - "Sistemi Nacional për Monitorimin e Spektrit Frekuencor do të mundësojë monitorimin e shfrytëzimit të resurseve frekuencore, identifikimin dhe zbulimin e burimeve të interferencave, ngritjen e nivelit të sigurisë nacionale, nxënien e brezave të caktuara frekuencore në tërë territorin e Kosovës, që njëherësh, janë konform obligimeve ndërkombëtare të cilat i ka vendi ynë", ka thënë kryeministri Albin Kurti në ceremoninë e inaugurimit të Sistemit Nacional për Monitorim të Spektrit Frekuencor - Sistemin SNMS, organizuar në Shipol të Mitrovicës.

Kryeministri Kurti ka theksuar se falë projekteve të zbatuara nga Ministria e Ekonomisë, sot Kosova është më i mbuluar me infrastrukturë brezgjere, si dhe është duke i bërë hapat e parë për shtrirjen e rrjeteve mobile 5G.

"Shtrirja e rrjeteve mobile 5G kërkon monitorim dhe analizim të sofistikuar të brezit frekuencor", ka thënë Kurti.

Qeveria e Kosovës që nga fillimi i mandatit të vet e ka përkrahur projektin KODE dhe rrjedhimisht edhe projektin e SNMS-së. Ky projekt është shpallur projekti



me qëllim të mbrojtjes nacionale me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datën 13 prill të vitit 2021. "Infrastruktura digjitale është një nga parakushtet për digjitalizimin që e synojmë në qeveri dhe në ekonomi. Zhvillimet në digjitalizim duhet të shoqërohen me masat përkatëse për rritjen e sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve.

Prandaj, Qeveria e Kosovës i kushton rëndësi të veçantë sigurisë kibernetike si nga aspekti i politikëbërjes, po ashtu edhe ndërmarrjes së masave konkrete, që i adresojnë rreziqet për sigurinë tonë kibernetike", ka potencuar kryeministri Kurti.

Javën e kaluar në qeveri u aprovua Projektligji për Siguri Kibernetike, që themelon Agjencinë për Siguri

Kibernetike, si institucion kyç përgjegjës për caktimin dhe zbatimin e masave për siguri kibernetike në Republikën e Kosovës, që do të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve nacionale në fushën e sigurisë kibernetike.

Kryeministri Kurti ka hënë se me zbatimin e Sistemit Nacional për Monitorimin e spektrit frekuencor po ndërmarrin një hap konkret, i

cili ka implikim direkt në sigurinë kibernetike të vendit tonë. "Si kryeministër i Qeverisë së Kosovës ju siguroj që do ta mbështes ARKEP-in, KPM-në, Ministrinë e Ekonomisë dhe të gjithë aktorët e tjerë relevantë dhe nuk do të hezitohem të bashkëpunojmë me partnerët tanë ndërkombëtarë, që sistemet e tilla të mund të përdoren në mënyrë sa më efikase", shtoi ai.

Kryeministri falënderoi në mënyrë të veçantë Bankën Botërore për mbështetjen e pazezervë të institucioneve tona, në këtë rast Ministrisë së Ekonomisë dhe të ARKEP-it në zhvillimin e këtij projekti shumë me rëndësi, por edhe në zhvillimin e Programit për Ekonominë Digjitale të Kosovës, Programi KODE. "Mirënjohje të veçanta i takojnë kompanisë zbatuese të projektit TCI International, që vjen nga shteti mik amerikan", ka thënë ai.

Në ceremoninë e inaugurimit të pranishëm ishin edhe ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, përfaqësues të Bankës Botërore, ARKEP-it, ambasadës dhe kompanisë zbatuese amerikane, si dhe përfaqësues të institucioneve dhe organizatave partnere.

PDK-ja del me pesë propozime për dalje nga kriza ekonomike

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Koordinator i Departamentit për Financa në Kabinetin për Qeverisje të Mirë, Arben Mustafa, në një konferencë për medie ka prezantuar në detaje pesë propozimet e kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, për t'u dalë në ndihmë qytetarëve në përballje me krizën ekonomike.

Partia Demokratike e Kosovës kërkon që: 1. Të lirohen nga TVSH-ja të gjitha mallrat esenciale të konsumit për një periudhë gjashtë-mujore. Duke marrë parasysh se kostoja mesatare e shportës së produkteve ushqimore esenciale për një familje kosovare është rreth 422 euro, nga kjo masë një familje mesatarisht do të përfitonte një zbritje të kostonë së jetesës prej 33,76 euro në muaj; 2. Të lirohen nga akciza produktet e naftës për një periudhë gjashtë-mujore, gjë e cila do të ulë çmimin e naftës për 36 centë në litër. Duke supozuar një shpenzim mujor prej 60 litra naftë në muaj për një familje,



atëherë përfitimi direkt mesatar mujor nga kjo masë do të ishte 21.6 euro në muaj; 3. Të lirohet nga TVSH-ja konsumi i energjisë elektrike për një periudhë gjashtë-mujore dhe të subvencionohen me 25 % faturat e atyre që konsumojnë deri në 1200 kwh. Duke marrë për bazë një faturë prej rreth 90 euro që rezulton nga një konsum i tillë, atëherë vlerësojmë se përfitimi mujor

nga kjo masë për një familje do të jetë 27.9 euro; 4. Të rriten pagat, pensionet dhe ndihmat sociale për të paktën aq sa është norma mesatare e inflacionit (rreth 15 %). Nëse e marrim për bazë pagën mesatare prej 484 euro sa ka qenë në vitin 2021, atëherë përfitimi mujor nga kjo masë për punonjësit do të ishte rreth 72.6 euro në muaj; dhe 5. Të lejohet tërheqja deri në 30 % e kursimeve pensionale dhe të

rimbursohet gradualisht shuma e tërhequr për kontribuuesit që kanë më pak se 10 000.00 euro në llogaritë e Trust-it. "Nëse i mbledhim efektet e pritura vetëm nga katër masat e para, pa e përfshirë tërheqjen e mjeteve nga Trusti, atëherë shohim se përfitimi për një familje mund të arrijë mesatarisht deri në 155 86.00 euro për muaj gjatë gjashtë muajve të ardhshëm, që

i bie mesatarisht 935.16 euro për gjashtë muaj", ka thënë koordinatori i Departamentit për Financa në Kabinetin për Qeverisje të Mirë, Arben Mustafa.

Ai e ka kritikuar Qeverinë e Kosovës për mënyrën se si i është përgjigjur krizës ekonomike, duke e quajtur joserioze dhe përjashtuese, e cila nuk përfshin të gjitha kategoritë e shoqërisë.

Mustafa ka shtuar se plani pesëpikësh i propozuar nga PDK-ja paraqet një kornizë më të dinjitetshme dhe më gjithëpërfshirëse të mbështetjes së qytetarëve. "Këto masa paraqesin një kornizë më të dinjitetshme dhe më gjithëpërfshirëse të mbështetjes së qytetarëve, duke përfshirë edhe sektorin privat që deri më tani nuk ka gëzuar mbështetje domethënëse nga e shtetit. Me zbatimin e këtyre masave, qytetarëve do t'u ofrohej siguri për periudhën e ardhshme dhe, po ashtu, për shkak të kësaj së kërkueses së gjithëpërfshirëse, do të ndihmohej rigjallërimi i aktivitetit ekonomik, i cili po shfaqet me tendencë të dobësimit", ka deklaruar Mustafa.

Mos i mësoni fëmijët tuaj të kenë frikë nga bota



Nga Arthur C.BROOKS

Nëse jeni prind, frika juaj më e madhe në jetë ka të ngjarë se mos i ndodh diçka njërit prej fëmijëve tuaj. Sipas një sondazhi të vitit 2018 nga "OnePoll", prindërit në SHBA shpenzojnë mesatarisht 37 orë në javë duke u shqetësuar për fëmijët e tyre. Dhe shqetësimi kryesor ka të bëjë me sigurinë e tyre gjatë rikthimit në shkollë.

Ky shqetësim është logjik, nëse besoni se siguria është një themel që duhet vendosur, përpara se të merreni me probleme të tjera. Efektet e këtij ankthi në sjelljen moderne të prindërimit, mund të shihen fare qartë. Sipas një raporti të vitit 2015 nga Qendra Kërkimore Pju, prindërit thonë se fëmijët duhet të jenë të paktën 10 vjeç që të mund të luajnë pa mbikëqyrjen e tyre në oborrin e shtëpisë, 12 vjeç për të qëndruar vetëm në shtëpi për 1 orë, dhe 14 vjeç për të luajtur të pambikëqyruar në një park publik.

Kjo shfaqet edhe tek ajo që prindërit u mësojnë fëmijëve të tyre për botën. Gjatë një studimi të botuar në "Journal of Positive Psychology" në vitin 2021, psikologët Xheremi Klifton dhe Peter Meindell, zbuluan se 53 për qind e të anketuarve preferonin të paralajmëronin fëmijët e tyre mbi shkaqet e "botës së rrezikshme" që i pret ata jashtë.

Nuk ka asnjë dyshim, se këto besime burojnë nga qëllimet më të mira të prindërve. Nëse dëshironi që fëmijët tuaj të jenë të sigurt (dhe për pasojë të lumtur), atëherë duhet t'u mësoni atyre se bota është e rrezikshme. Në këtë mënyrë, ata do të jenë më vigjilentë dhe më të kujdesshëm.

Në fakt, t'u thuash këtë gjë është e dëmshme për shëndetin, lumturinë dhe suksesin e tyre. Pasi qasja se bota është kryesisht e pasigurt ose e rrezikshme, është ajo që disa psikologë e quajnë "besimi parësor mbi botën". Klifton dhe Meindell thonë se nëse një fëmijë nxitet të besojë se bota është e

rrezikshme, kjo do të ndikojë shumë tek mënyra se si ai do t'i shohëshumë pjesë të tjera të jetës, marrëdhëniet dhe punës.

Pra do të jetë më dyshues për motivet e njerëzve të tjerë. Për shembull do të ketë më pak gjasa të bëjë gjëra që mendon se mund ta rrezikojnë, si për shembull daljet mbrëmjeve me shoqërinë. Edhe pse shumica shpresojnë se paralajmërimi mbi rreziqet e botës, do t'i ndihmojë fëmijët provat tregojnë se kjo qasje shkakton pikërisht të kundërtën.

Në të njëjtin studim, Klifton dhe Meindell tregojnë se njerëzit që kanë besime parësore negative mbi botën, janë më pak të shëndetshëm sesa bashkëmoshatarët e tyre, janë më shpesh të trishtuar, kanë më shumë gjasa të bien në depresion, dhe janë më pak të kënaqur me jetën e tyre.

Po ashtu ata të mos pëlqejnë punët që bëjnë, dhe të kenë një rendiment më të dobët se kolegët e tyre që kanë një pikëpamje më pozitive mbi botën. Një shpjegim për këtë është se njerëzit në rrethana të këqija (varfëri, sëmundje etj.) kanë edhe rezultate të këqija, por dhe më shumë arsye për të frikësuar.

Por siç argumentojnë Klifton dhe Meindell, besimet parësore mbi botën, mund të ndërveprojnë edhe me rezultatet që arrin dikush në jetë. Një njeri ka të ngjarë të vuajë shumë më tepër, kur është gjithmonë vigjilent ndaj rrezikut dhe në përpjekje për ta shmangur atë.

Mësimi i fëmijëve se bota është e rrezikshme, mund t'i bëjë ata më pak tolerantë ndaj të tjerëve. Për të hequr dorë nga ky model, prindërit – dhe cilido që ndërvepron me fëmijët – duhet të punojnë për të kultivuar tek ata ndjenjën e sigurisë. Dhe këtu mund t'u ndihmojnë 3 këshilla.

1. Shëroni veten

Prindërit mund t'i ushqejnë fëmijët e tyre me pikëpamje negative mbi botën, pasi ata

vetë kanë pikëpamje të tilla. Dhe kjo mund të ndodhë lehtësisht në një botë ku bombardohemi çdo ditë me lajme dhe informacione, të cilat studimet i kanë lidhur me shqetësimin, ankthin dhe depresionin. Dhe hulumtimet tregojnë se shumë prindër ua përcjellin ankthin fëmijëve të tyre. Një nga mënyrat për të zbutur frikën tonë, është thjesht të shohim faktet. Siç shprehet gazetari Kristofer Ingraham, të qenit fëmijë në Amerikë nuk ka qenë kurrë më i sigurt se sot.

Që nga viti 1935, numri i vdekjeve të fëmijëve midis moshës 1-4 vjeç ka rënë nga 450 në 30 për 100.000 banorë aktualisht. Ai është përgjysmuar që nga viti 1990, dhe rënia tek grupmoshat e tjera janë po aq mbresëlënëse. Përdoreni këtë njohuri për të kundërshtuar fokusin e pamëshirshëm të medias mbi frikën dhe rrezikun.

2. Jini specifik dhe proporcionalë

Të rriturit duan që t'u mësojnë të rinjve se si të jenë të sigurt përballë kërcënimeve. Por studimet tregojnë se një qasje plot frikë ndaj botës, mund t'i bëjë ata më pak të aftë për ta bërë atë. Nëse dëshironi ta paralajmëroni fëmijën për ta përgatitur atë më mirë për jetën, përqendrohuni tek një rrezik specifik me të cilin mund të përballet, dhe si ta trajtoni atë.

Në vend se t'i thoni "Kujdes, njerëzit do të përpiqen të përfitojnë nga ty kur të jesh në gjimnaz", thojini "Nëse dikush përpiqet të të joshë të pish shumë alkool, atëherë shmangeni atë person". Kur duhet t'i flisni fëmijës për një kërcënim, sigurohuni që ta ruani proporcionalitetin. Për shembull, unë nuk dua që dikush të silltet keq me fëmijët e mi më shumë sesa një prind tjetër. Ata e dinë këtë. Por nuk më ndihmon të them se fjalët armiqësore i bëjnë ata të pasigurt. Konflikti social është diçka e pashmangshme. Ndaj t'i

frikësosh fëmijët me të si një kërcënim ekzistencial, do të thotë t'u japësh atyre një besim parësor negativ, duke i bërë ata më pak rezistentë ndaj sfidave.

3. Kundërveproni nga jashtë ndaj pikëpamjeve të errëta mbi botën

Gati çdo ditë që vajza ime ishte në shkollë e mesme, mësuesit i mësonin se bota është e rrezikshme. Pra i flisnin mbi njerëzit e këqij, forcat e rrezikshme në natyrë, dhe mbi një të ardhme të zymtë që e priste SHBA-në. Ajo na i tregonte çdo mbrëmje kur hanim darkë të gjitha këto gjëra, dhe unë vëreja me shqetësim pesimizmin e saj në rritje.

Ndaj bashkë me gruan, nisëm që t'i kundërvihemi qëllimisht narrativës së frikshme. Nuk i hodhëm poshtë kërcënimet. Por u përpoqëm të ishim më specifikë në lidhje me sjelljet e mira që shihnim dhe mënyrat se si sot bota është më e sigurt dhe më e begatë sesa dikur.

Të punosh shumë për të shmangur induktimin e frikës tek fëmijët është diçka pozitive. Por ne të gjithë duhet të jemi në gjendje të bëjmë më mirë se sa kaq, dhe të përpiqemi të kultivojmë një besim parësor pozitiv që mund të përmirësojë vërtet jetën e tyre.

Për këtë i unë i drejtohem shpesh fjalëve të filozofit kinez Lao Tzu. "Nëpërmjet dashurisë, njeriu nuk ka frikë nga bota" – shkroi ai në Tao Te Ching. Pra në vend se t'u mësojmë fëmijëve tanë frikëra të tilla, le t'u mësojmë atyre dashurinë, që e neutralizon frikën dhe qëkrijon diçka të mirë në vend të saj. Ndaj thojini atyre se njerëzit janë krijuar për dashuri, se ne të gjithë e dëshirojmë atë, dhe se mund të gjejmë diçka të dashur gati tek të gjithë ata që takojmë. / "The Atlantic" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Ballkani shkëlqen ndaj Ferizajt

FERIZAJ, 19 SHTATOR - Skuadra e Ballkanit ka shënuar fitore sot në përballje me skuadrën e Ferizajt me rezultat 0-3. Vendasit e drejtuar nga trajneri Arbnor Morina janë mbajtur vetëm deri në fund të pjesës së parë, kur Albion Rrahmani shënoi për 0-1. Raste shënimi pati edhe Ferizaj, por që nuk i konkretizoi në gol. Në minutën e 68 Leotrim Bekteshi e shënoi golin e dytë në ndeshje dhe të qetësisë për mysafirët. Rezultatit final në këtë ndeshje e vulosi në

minutën e 77, Meriton Korenica. Ballkani pas kësaj ndeshje zë vendin e tretë në renditjen tabelore me 12 pikë, por ka dy ndeshje më pak të zhvilluara se Drita që është lidere. Kampioni në fuqi i Kosovës ka shkruar historinë edhe në garat ndërkombëtare, duke u bërë klubi i parë që arriti të kualifikohet në fazën e grupeve të Ligës së Konferencës, ku në dy ndeshjet e para ka pasur paraqitje të mira dhe ka regjistruar një barazim dhe një humbje.



'Dardanët' për dy ndeshjet në Ligën e Kombeve: Kërkojmë vetëm fitore



PRISHTINË, 19 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll sot i fillon përgatitjet për dy ndeshjet e fundit të këtij edicioni në Ligën e Kombeve. Të përzgjedhurit e Alain Giresse më 24 shtator do të luajnë si mysafirë kundër Irlandës së Veriut, derisa më 27 shtator do të jenë mikpritës të Qipros në stadiumin "Fadil Vokrri". Në prag të këtyre dy ndeshjeve, grupi i tifozëve "dardanët" ka dalë me një mesazh nëpërmjet të cilit ka

kërkuar që bashkë me rikthimin e ndeshjeve të kthehet edhe ndjenja e përgjegjësisë, vullnetit dhe angazhimit për ta nxjerrë më të mirën. "Kërkojmë konsideratë për tifozët, të jenë më të afërt dhe të mos harrojnë që jemi në tifozët ata që nuk i trajtojmë si numra e lecka, por i glorifikojmë, përkrahim dhe çmojmë për hir të asaj fanelle që veshin dhe vendit që përfaqësojnë. Dëshirojmë t'i shohim prapë djemtë me këmbë përtokë. Dëshirojmë t'i

gëzohemi sërish fitores. Asnjë pretekst nuk ka vend. Duam me çdo kusht që ta përmbylim këtë kapitull të Ligës së Kombeve me fitore. Ne si 'dardanët' për herë të fundit ishim të pranishëm në Greqi. Sërish do të jemi afër Përfaqësueses, si në Irlandë Veriore, ashtu edhe në ndeshjen e fundit në 'Fadil Vokrri' kundër Qipros. Duam lojtarë të motivuar. Kërkojmë vetëm fitore", kanë shkruar "Dardanët" në faqen zyrtare në "Facebook".


Dodd, MVP i javës së dytë në Superligë

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Java e dytë në Prince Caffë Superligën e Kosovës në basketboll ka dhuruar disa ndeshje interesante. Vëllaznimi regjistroi fitoren e parë për këtë edicion në elitë, apo edhe të parën pas një viti në Superligë. Kuqezinjtë të mbështetur nga tifozët e tyre fituan ndaj Rahovecit 94:87 pas dy vazhdimëve. Më i dalluari ishte qendra Damonte Dodd me 16 pikë, 20 kërcime, pesë asistime dhe nëntë bllokada, duke e pasur indeksin e ndeshjes 39. Rodney Purvis zhvilloi një tjetër ndeshje të mirë, kësaj radhe ndaj Ponte Prizrenit, duke qenë më i dalluari te pejanët. Purvis kishte 31 pikë, gjashtë kërcime e

katër asistime. Në anën tjetër, bindshëm më i miri te Ponte Prizreni ishte organizatori Ivan Koljeviq me 32 pikë, tetë kërcime dhe 11 asistime. Trepça regjistroi fitoren e dytë këtë edicion, ku fituan ndaj Bashkimit, kurse më i dalluari ishte basketbollisti i Kombëtares së

Kosovës, Erjon Kastrati, me 20 pikë, dy kërcime dhe katër asistime. Sigal Prishtina shënoi fitoren e parë, duke mundur kampionin aktual Golden Eagle Yllin, ku më i miri në parket te bardhekaltrit ishte Dustin Thomas me 16 pikë, shtatë kërcime dhe dy asistime.

TOP PESËSHJA		
Damonte Dodd	(Vëllaznimi)	16 pikë, 20 kërcime, 5 asistime, 9 bllokada
Rodney Purvis	(Peja)	31 pikë, 6 kërcime, 4 asistime
Ivan Koljeviq	(Ponte Prizreni)	32 pikë, 8 kërcime, 11 asistime
Erjon Kastrati	(Trepça)	20 pikë, 2 kërcime, 4 asistime
Dustin Thomas	(Sigal Prishtina)	16 pikë, 7 kërcime, 2 asistime



Topalli: Prisa ftesë nga Giresse, jam i dëshpëruar

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës, Alain Giresse, e ka bërë publike listën e futbollistëve për dy ndeshjet e këtij muaji. Trajneri francez për grumbullimin e shtatorit ka ftuar 26 futbollistë, të cilët do t'i ketë në dispozicion për duelet me Irlandën e Veriut, më 24 shtator, në Belfast dhe me Qipron, më 27 shtator, në Prishtinë. Këto dy ndeshje janë të fundit në kuadër të ciklit të

sivjetmë të Ligës së Kombeve. Në këtë listë nuk është përfshirë Jetmir Topalli, lojtar i cili po kalon nëpërmjet formës shumë të mirë te skuadra turke Instambulspor, edhe pse e kishte pritur një ftesë nga të tillë. Javë ma parë Topalli në një intervistë për "KosovaPress" deklaroi se është në pritje të ftesës nga trajneri Giresse dhe se është i gatshëm për ta ndihmuar Kosovën në fazën e sulmit dhe tani që nuk

është ftuar është shumë i zhgënjyer. Aikathënëse mosftesa nga ana e Giresse e ka lënë jashtëzakonisht të dëshpëruar, por përkundër kësaj do të vazhdojë të punojë edhe më shumë. "Patjetër që jam i dëshpëruar sepse kam shpresuar shumë që do të jem pjesë e këtij grumbullimi, por nuk kam çfarë të bëj. Duhet të punoj edhe me më shumë motiv dhe të shikoj përpara", ka thënë Topalli.



Nuza, gjyqtar kryesor në dy ndeshje kualifikuese për Evropianin U19

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Gjyqtarët e Kosovës vazhdojnë të tregohen të suksesshëm në garat evropiane pasi javën e kaluar ishin të deleguar në ndeshjen e Ligës së Konferencës, Gent-

Shamrock Rovers, Genc Nuza si gjyqtar kryesor dhe Granit Hyseni, si gjyqtar anësor, do ta ndajnë drejtësinë në turneun kualifikues për "Euro 2023" për kombëtaret e grupmohave 19 vjeç, që

zhvillohet në Rumani. Në këtë turne, krahas Rumanisë, marrin pjesë edhe Austria, Letonia dhe Lituania. UEFA e ka vlerësuar gjyqtarin Nuza, duke ia besuar ndeshjen kryesore të grupit, atë

ndërmjet Rumanisë dhe Austrisë, që zhvillohet më 27 shtator, teksa paraprakisht ai do ta gjykojë edhe ndeshjen ndërmjet Austrisë dhe Lituaniës, që zhvillohet më 21 shtator.



'Mbreti' i ri i Evropës, Haalandi, lë pas dyshen Messi - Ronaldo

MANCHESTER, 19 SHTATOR - Momenti i artë i Erling Haalandit vijon t'i magjepsë tifozët e futbollit. Shifrat e "bomberit" norvegjez janë fantastike: 11 gola në 7 ndeshje në Premierë Ligë, 14 në 9 ndeshje, duke përfshirë këtu edhe dy sfidat në Ligën e Kampionëve. Haalandi ka shënuar i vetëm më shumë sesa 13 ekipe në Premierë Ligë, përfshirë këtu edhe Manchester Unitedin e Chelseas, të dyja këto ekipe kanë shënuar vetëm 8 gola. Pavarësisht se është vetëm 22-vjeçar, sapo i ka mbushur, Haaland mund të krahasohet lehtësisht me dy yjet e futbollit botëror, Leo Messi dhe Cristiano Ronaldo, madje Haalandi ka disa shifra edhe më të mira duke vendosur rekorde personale. Në sezonin e tij më të mirë në karrierë, Ronaldo realizoi 48 gola në La Liga dhe 10 në Ligën e Kampionëve. 58 golat në total, Ronaldo i realizoi me 295 goditje, mesatarisht 1 gol çdo 5 gjuajtje. Messi në sezonin e tij më të mirë në



karrierë realizoi 43 gola në La Liga dhe 10 në Ligën e Kampionëve, këto i arriti me 237 gjuajtje, 1 gol çdo 4,5 gjuajtje. Haalandi në këtë sezon të tij të parë me Manchester Cityn 14 golat i ka shënuar me vetëm 37 gjuajtje: 1 gol çdo 2,6

tentativa. Jo vetëm kaq, Haalandi kalon si Messin ashtu edhe Ronaldon në një tjetër statistikë. Në 6 mijë minutat e tij të para në karrierë Haaland ka shënuar 73 gola, Ronaldo ka realizuar 12 dhe Messi 40 gola.

Ish-mekaniku i McLarenit: Alonso paguante mekanikët për të punuar me atë dhe jo me Hamiltonin

Oviedo, 19 shtator - Në vitin 2007, dy nga veteranët e sportit të Formulës 1, spanjoli Fernando Alonso dhe britaniku Lewis Hamiltoni, garon së bashku te skuadra McLaren Mercedes. Asokohe rivaliteti mes dy pilotëve ishte i madh, duke pasur edhe shkëndija në pistë. Titulli botëror atë vit u fitua nga Kimi Raikkonen me Ferrarin, por ajo kohë jo fort e mirë për dy pilotët është rikthyer sot nga akuzat e një ish-mekaniku të McLarenit, Marc Priestley. Ai ka qenë për 10 vjet me radhë anëtar i kësaj skuadre. Ai ka folur për një strategji antisportive nga ana e Alonsos. Sipas mekanikut, spanjoli i paguante inxhinierët, duke u dhënë zarfe me para, në mënyrë që ata të ndihmonin më shumë atë dhe të dilnin kundër Hamiltonit. "Një nga taktikat e Alonsos ishte ajo që të kishte gjithë skuadrën në anën e tij në garazh. Një ditë, në



vitin 2007, menaxheri apo trajneri i tij, erdhi me zarfe të vegjël në Formula 1, të mbushura me para. Ato u jepeshin personave që nuk punonin te makina e Lewisit", ka thënë ish-mekaniku i McLarenit. "Hapa zarfin dhe brenda ishin 1 500.00 euro. Nuk kishte asgjë të

shkuar në të dhe t'i merr një zarf, i thua faleminderit dhe shih se brenda pa para. Të vetmit që nuk morën zarfin ishin ata që punonin te makina e Hamiltonit. Në fund, skuadra e mori vesh dhe u fshih gjithçka si një dhurim për bamirësi", ka shtuar ish-mekaniku.

SHKURT

Pioli: Zhgënjim kur humb kështu, luajtëm më mirë se Napoli

Milani u mposht në "San Siro" nga Napoli dhe trajneri Stefano Pioli pas ndeshjes theksoi se skuadra e tij nuk e meritoi aspak humbjen me lojën që bëri. "Humbëm sepse nuk luajtëm me vendosmërinë që nevojitet. Ne luajtëm më mirë se Napoli. Është për të ardhur keq që humbëm ecurinë e pamposhtur me një paraqitje të tillë. Është e vështirë ta fajësosh mbrojtjen, keqardhja më e madhe është se shënuam vetëm një gol. Është e vështirë t'i atribuojmë diçka fazës sonë të mbrojtjes, pasi i kemi lënë pak një ekipi që zakonisht krijon shumë. Mund të të ndodhë nata e keqe, negative, kur kundërshtari bën më mirë se ti. Kështu ka zhgënjim, nuk duhej të humbnim. E humbëm këtë ndeshje pasi nuk kishim agresivitetin dhe saktësinë e duhur në të dy zonat", ka thënë Pioli.

Juventusit në krizë rezultatesh, Allegri nuk shkarkohet

Juventusit ka vazhduar me formë jo të mirë teksa ka humbur edhe nga Monza me rezultat 1-0. "Zonja e Vjetër" po ka vështirësi të mëdha ta gjejë formën e duhur dhe ka rezultate zhgënjyese edhe në Ligën e Kampionëve. Drejtori sportiv Maurizio Arrivabene e ka mohuar se trajneri Massimiliano Allegri do të shkarkohet. "Të ndryshojmë tani drejtim teknik të skuadrës do të ishte një çmenduri. Sot për sot problemet duhen parë në tërësi. Kemi dalë nga disa vjet të vështirë që kanë rënduar jo vetëm në futboll. Të bësh gjyqe popullore nuk ndihmon një klub si Juventusit. Max nuk ka vetëm një kontratë, por një program për ta zhvilluar në katër vjet. Ashtu siç kam edhe unë një program", ka thënë Arrivabene. "Nëse duhet të gjendet një fajtor, atëherë ai jam unë. Sepse administratori i deleguar është në krye të klubit dhe më takon mua e gjithë përgjegjësia. Duhet përlësi, qartësi dhe vendosmëri. Kemi probleme, por nuk zgjidhen duke akuzuar vetëm një person. Duhet të punojmë së bashku dhe të shohim përpara", ka deklaruar Arrivabene.

Spanja shpallet kampione e Evropës në basketboll

Spanja është kampione e Evropës në basketboll. Kombëtarja spanjolle ka shënuar fitore në finalen e madhe të "EuroBasket 2022", që është zhvilluar të dielën në "Berlin Arena". Spanja në finale mposhti Francën me rezultatin 88:76. Më meritoret në këtë triumf të spanjollëve ishin Juancho Hernangomez me 27 pikë dhe Lorenzo D'ontez Brown e Willy Hernangomez që shtuan nga 14 pikë secili. Te kombëtarja franceze u dallua Evan Fournier me 23 pikë. Për Spanjën është kjo hera e katërt që shpallet kampione e Evropës. Gjermania e fitoi vendin e tretë pasi sot mposhti Poloninë. Renditja përfundimtare e "EuroBasket 2022" është Spanja, Franca, Gjermania, Polonia, Greqia.

Mazepin: Nuk heq dorë nga nënshtetësia ruse, do të garoj sërish në Formula 1

I përjashtuar nga Formula 1 pak kohë para se të nisnin garat e këtij sezoni, për shkak të nënshtetësisë ruse dhe faktit se Rusia pushtoi Ukrainën, piloti Nikita Mazepin e pa veten pa një veturë. Ish-piloti i Haas nuk

garon prej muajsh, ndërkohë që edhe sponsorët e tij rusë u përjashtuan nga makina amerikane, duke nisur disa procese gjyqësore. Kur kanë kaluar disa muaj nga ai vendim, piloti 23-vjeçar shprehet se nuk

e ka pranuar kurrë atë vendim të FIA-s. Në një intervistë për mediet ruse, ai ka thënë: "Më kërkuan që të dal kundër luftës duke firmosur një dokument të FIA-s, por nuk e kam pranuar atë gjë. Dëshiroj që sportistët të

jenë neutralë në të tilla gjëra, duke mos bërë politikë. Jemi sportistë e secili bën zgjedhjen e tij. Shwartzman, për shembull, vendosi të heqë dorë nga nënshtetësia ruse (garon me patentë izraelite), por ky

ishte vendimi i tij personal. Ndërsa unë nuk do të heq dorë nga nënshtetësia ruse dhe e di që një ditë do të rikthehem në Formula 1", u shpreh Mazepin, që është në gjyq me skuadrën Haas.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita: Zyrtar i Ri Ligjor
Departamenti: Juridik
Niveli i gradës: 7
Raporton tek: Drejtori i Departamentit Juridik

Përmbledhje e Detyrave dhe Përgjegjësisë:

- Asiston në përmbushjen e detyrave të përgjithshme të Departamentit Juridik;
- Kryen hulumtime dhe përgatitë opinione ligjore mbi çështje të ndryshme sipas kërkesës së mbikëqyrësit;
- Asiston në hartimin dhe përditësimin e kornizës ligjore të bankës qendrore;
- Asiston në zgjidhjen e çështjeve ligjore në bashkëpunim me zyrtarët tjerë ligjor;
- Shqyrton marrëveshjet, kontratat dhe të gjitha dokumenteve tjera ligjore bazuar në kërkesat e mbikëqyrësit;
- Ofron ndihmë për departamentin gjatë përgatitjes dhe finalizimit të të gjitha dokumenteve ligjore;
- Bën hulumtime për çështje ligjore për departamentin;
- Përpilon shkresa të ndryshme sipas kërkesave;
- Menaxhon të gjitha detyrat dhe shërbimet ligjore brenda afateve të caktuara.
- Sipas autorizimit, merr pjesë në komisione dhe grupe punuese;
- Përgatitë raporte dhe evidenca lidhur me kryerjen e punëve brenda përgjegjësisë të Departamentit Juridik;
- Kryen të gjitha detyra të tjera të caktuara sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Diplomë universitare në fushën e drejtësisë;
- Njohuri të sistemit ligjor dhe ligjeve të Kosovës, veçanërisht atij të sistemit financiar, të punës, mbi procedurën kontestimore, përbarimore, ligji për marrëdhëniet e detyrimeve, si dhe kodin penal dhe të procedurës penale, etj;
- Njohje e mirë e legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushat e lartcekura;
- Rrjedhshmëri në të folur dhe në të shkruar e gjuhës shqipe dhe/ose serbe;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi;
- Njohje e aplikacioneve të MS-Office;

Përvoja e kërkuar:

- Përvojë pune profesionale në fushën ligjore e preferueshme;

Kërkesat e posaçme:

- Vëmendje në detaje, në formulime të qarta dhe saktësi;
- Aftësi komunikuese në të shkruar si dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve sipas prioriteteve;
- Vetëiniciativë dhe gatishmëri për punë ekipore;
- Ruajtja e fshehtësisë afariste.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **04 tetor 2022**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare: www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**



OBJAVLJIVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Pozicija: Mladi pravni službenik
Odeljenje: Pravno
Stepen: 7
Izveštava kod: Direktora Pravnog odeljenja

Sažetak dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže u ispunjavanju opštih dužnosti Pravnog odeljenja;
- Sprovodi istraživanja i priprema pravna mišljenja o raznim pitanjima prema zahtevu nadređenog;
- Pomaže u izradi i ažuriranju pravnog okvira centralne banke;
- Pomaže u rešavanju pravnih pitanja u saradnji sa ostalim pravnim službenicima;
- Razmatra sporazume, ugovore i sva ostala pravna dokumenta na osnovu zahteva nadređenog;
- Pružna pomoć za odeljenje tokom pripreme i finalizacije svih pravnih dokumenata;
- Sprovodi istraživanja o pravnim pitanjima za odeljenje;
- Sastavlja razne dopise prema zahtevu;
- Upravlja svim pravnim poslovima i uslugama u skladu sa određenim rokovima.
- Prema ovlašćenju, učestvuje u komisijama i radnim grupama;
- Priprema izveštaje i evidencije vezano za obavljanje poslova u okviru nadležnosti Pravnog odeljenja;
- Obavlja sve ostale zadatke određene prema zahtevu nadređenog.

Kvalifikacije i potrebno iskustvo:

- Univerzitetska diploma u oblasti prava;
- Poznavanje pravnog sistema i zakona Kosova, posebno finansijskog i radnog sistema, o parničnom i izvršnom postupku, zakonu o obligacionim odnosima, kao i krivičnom zakoniku i krivičnom postupku itd;
- Dobro poznavanje zakonodavstva Evropske unije u gore navedenim oblastima;
- Tečno govorenje i pisanje albanskog i/ili srpskog jezika;
- Poznavanje engleskog jezika je prednost;
- Poznavanje aplikacija MS-Office;

Potrebno iskustvo:

- Profesionalno radno iskustvo u pravnoj oblasti je poželjno;

Posebni zahtevi:

- Pažnja prema detaljima, u jasnom i tačnom formulisanju;
- Komunikacijske veštine u pisanju, kao i veštine za rešavanje problema po prioritetima;
- Samoinicijativa i spremnost za timski rad;
- Čuvanje poslovne tajne.

Svi kandidati moraju da dostave sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Prateće (motivaciono) pismo gde se naglašava interesovanje za ovu poziciju;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju da budu priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom prebivalištu na Kosovu.

Postupak apliciranja:

- Poslednji rok za apliciranje je **4. oktobar 2022**.
- Apliciranje se može uraditi online (<https://hris.bqk-kos.org>) putem zvanične stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi način apliciranja neće se uzeti u obzir.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti preko zvanične stranice: www.bqk-kos.org
- Nepotpuna dokumentacija neće biti uzeta u obzir. Samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa biće kontaktirani.**



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli:	Zyrtar i ri për Operacione me Para të Gatshme
Departamenti:	i Parave dhe Marrëdhënies Bankare
Divizioni:	i Parave të Gatshme
Niveli i gradës:	7
I raporton:	Udhëheqësit të Divizionit të parave të gatshme

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit ndihmon në kryerjen e depozitave dhe tërheqjeve të parave të gatshme sipas planit të termineve të klientëve;
- Në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit ndihmon në përgatitjen e tërheqjeve të parave të gatshme sipas planit të termineve të klientëve;
- Në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit pranon depozitat e parave të gatshme nga palët;
- Në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe zyrtaret e tjerë të Divizionit ndihmon në procesin e përgatitjes së tërheqjeve të parave të gatshme nga palët;
- Në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit regjistron në sistemin e kontabilitetit transaksionet ditore me para të gatshme;
- Në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit angazhohet në procesimin e parave të gatshme;
- Në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit merr pjesë në hapjen dhe mbylljen e Trezorëve sipas rregullave dhe procedurave;
- Asiston Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit gjatë procesit të reconciliimit të gjendjes së parave të gatshme në trezorë me gjendjen e kontabilitetit;
- Asiston Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit gjatë procesit të përgatitjes, transportit dhe logjistikës së parave të gatshme;
- Në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit angazhohet në regjistrimet e parave të gatshme;
- Kryen punë të tjera të ndërlidhura me operacionet me para të gatshme dhe të Trezorit.

Edukimi:

- Diplomë universitare;
- Preferohet të ketë njohuri mbi veçoritë e sigurisë së kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe njohuri mbi makinat moderne për procesim të parave të gatshme;
- Njohuri e mirë e aplikacioneve MS office dhe aplikacioneve bankare.

Përvoja e punës:

- Përvoja e punës si Trezorist, Procesues i parave të gatshme ose Arkëtar është e dëshirueshme.

Njohja e gjuhëve të huaja:

- Njohuri e shkëlqyeshme e gjuhës shqipe dhe/ose serbe;
- Njohuri e gjuhës angleze është e dëshirueshme.

Kërkesat e posaçme:

- Të mos ketë qenë asnjëherë subjekt i ndonjë veprë penale;
- Mbajtje e lartë e fshehtësisë;
- Vëmendje në detaje dhe saktësi;
- Aftësi të shkëlqyeshme bashkërenduese; dhe
- Aftësi të mira komunikimi.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuar zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Certifikatën nga gjykata e cila dëshmon, se nuk keni qenë asnjëherë subjekt i ndonjë veprë penale (jo më të vjetër se 3 muaj); dhe
- Vërtetimin nga Policia që dëshmon se nuk jeni nën hetime (jo më të vjetër se 3 muaj).
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **04 tetor 2022**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**



OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Naziv:	Novi službenik za rad sa gotovinom
Odeljenje:	za novac i bankarstvo
Odsek:	za gotovinu
Stepen:	7
Izveštava:	upravniku Odseka za gotovinu

Dužnosti i odgovornosti:

- U koordinaciji sa šefom odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka pomaže u vršenju depozita i podizanja gotovine prema planu rasporeda klijenata;
- U koordinaciji sa šefom odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka pomaže u pripremi podizanja gotovine prema planu rasporeda klijenata;
- U koordinaciji sa šefom odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka prima gotovinske depozite od stranaka;
- U koordinaciji sa šefom odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka pomaže u procesu pripreme podizanja gotovine od stranaka;
- U koordinaciji sa šefom odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka evidentira u računovodstvenom sistemu dnevne transakcije gotovinom;
- U koordinaciji sa šefom odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka se angažuju u procesiranju gotovine;
- U koordinaciji sa šefom odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka učestvuje u otvaranju i zatvaranju trezora u skladu sa pravilima i postupcima;
- Pomaže šefu odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka tokom procesa izmirenja stanja gotovine u trezorima sa stanjem računovodstva;
- Pomaže šefu odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka tokom procesa pripreme, transporta i logistike gotovine;
- U koordinaciji sa šefom odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka se angažuje u evidenciji gotovine;
- Obavlja i druge poslove vezane za rad sa gotovinom i trezorom.

Obrazovanje:

- Fakultetska diploma;
- Poželjno je imati znanje o bezbednosnim svojstvima evro novčanica i metalnog novca kao i znanje o savremenim mašinama za procesiranje gotovine;
- Dobro poznavanje MS Office aplikacija i bankarskih aplikacija.

Radno iskustvo:

- Poželjno je radno iskustvo kao radnik na trezoru, radnik na procesiranju gotovine ili blagajnik.

Poznavanje stranih jezika:

- Odlično poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika;
- Poželjno poznavanje engleskog jezika.

Posebni uslovi:

- da nikada nije bio predmet nekog krivičnog dela;
- visoka poverljivost;
- pažnja prema detaljima i tačnosti;
- odlične veštine koordinacije; i
- dobre komunikacijske veštine.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo gde se ističe interesovanje za ovaj položaj;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Uverenje iz suda kojim se dokazuje da nikada niste bili predmet krivičnog dela (ne starije od 3 meseca); i
- Potvrda policije kojim se dokazuje da niste pod istragom (ne starija od 3 meseca).
- Dokaz o identitetu i stalnom boravku na Kosovu.

Postupak prijavlivanja:

- Krajni rok za prijavu je **4. oktobar 2022. godine**.
- Prijava se može izvršiti i putem interneta (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične stranice interneta CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi obrazac za prijavu neće se uzeti u obzir.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti sa zvanične internet stranice: www.bqk-kos.org
- Nepotpuna dokumentacija neće se razmatrati. Samo kandidati koji ispunjavaju uslove konkursa biće kontaktirani.**



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita:	Zyrtar i Licencimit
Departamenti:	Licencim dhe Standardizim
Divizioni:	Licencimit
Niveli i gradës:	6
Raporton tek:	Udhëheqësit të Divizionit të Licencimit/Drejtorit të DLS-së

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

- Zbaton Manualin dhe Procedurat e Licencimit dhe të gjitha rregullat e brendshme të Departamentit;
- Kontribuon në shqyrtimin, vlerësimin dhe analizimin e të gjitha aplikacioneve për licencim, në pajtim me kornizën ligjore në fuqi;
- Shqyrton, vlerëson dhe analizon, në rastet më të komplekse në bashkëpunim me Udhëheqësin e Divizionit të Licencimit apo Drejtorin e DLS-së, të gjitha kërkesat e të institucioneve financiare, të cilat i delegohen, në pajtim me kornizën ligjore në fuqi;
- Kontribuon në analizimin e raporteve biografike dhe financiare të aksionarëve, drejtorëve dhe menaxhmentit të lartë të institucioneve financiare;
- Përgatit rekomandimet për aprovime/refuzime/revokime të kërkesave të deleguara drejtuar Udhëheqësit të Divizionit të Licencimit, Drejtorit të DLS-së dhe Bordit Ekzekutiv;
- Shqyrton të gjitha kërkesat për hapje, zhvendosje dhe mbyllje të degëve dhe zyrave të institucioneve financiare;
- Kontribuon në shqyrtimin e të gjitha kërkesave për licencim/regjistrim të agjentëve/brokerave të institucioneve financiare;
- Kryen ekzaminimet e para hapjes në degët/zyrat e institucioneve financiare;
- Mirëmban dosjet fizike dhe elektronike të institucioneve financiare duke përfshirë regjistrat për personat kyq (aksionarët, drejtorët dhe menaxherët e lartë), zyrat e institucioneve financiare, agjentët dhe brokerat e institucioneve financiare;
- Kontribuon në draftimin e politikave, procedurave, manualeve të licencimit, rregulloreve, rregullave dhe udhëzimeve tjera të institucioneve financiare, të deleguara;
- Mbështet bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët relevante të Departamentit;
- Kryen të gjitha detyrat tjera të cilat i caktohen nga Udhëheqësi i Divizioni i Licencimit dhe Drejtori i DLS-së.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Diplomë bachelor në drejtimin; Juridik, Ekonomi, Financa dhe Kontabilitet;
- Të ketë provojë punë tre (3) vite në financa, kontabilitet, apo në industrinë e sigurimeve.
- Rrjedhshmëri në gjuhën shqipe dhe/ose serbe;
- Njohje e gjuhës angleze e preferuar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente;
- Raporti nga Trusti i cili e dëshmon periudhën kohore të përvojës së punës;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **04 tetor 2022**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**



OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Pozicija:	Službenik za licenciranje
Odeljenje:	Licenciranje i standardizacija
Divizija:	Licenciranje
Stepen:	6
Izveštava kod:	Rukovodioca Divizije za licenciranje/Direktoru OLS-a

Radne dužnosti i odgovornosti:

- Primenjuje Priručnike i procedure licenciranja i sva interna pravila Odeljenja;
- Doprinosi razmatranju, proceni i analizi svih prijava za licenciranje, u skladu sa važećim zakonskim okvirom;
- Razmatra, procenjuje i analizira, u najsloženijim slučajevima u saradnji sa rukovodiocem Divizije za licenciranje ili direktorom OLS-a, sve zahteve finansijskih institucija, koje se njemu delegiraju, u skladu sa važećim zakonskim okvirom;
- Doprinosi analiziranju biografskih i finansijskih izveštaja akcionara, direktora i višeg rukovodstva finansijskih institucija;
- Priprema preporuke za odobravanje/odbijanje/povlačenje zahteva delegiranih rukovodiocu Divizije za licenciranje, direktoru OLS-a i Izvršnom odboru;
- Razmatra sve zahteve za otvaranje, premeštanje i zatvaranje filijala i kancelarija finansijskih institucija;
- Razmatra sve zahteve za licenciranje/registraciju agenata/brokera finansijskih institucija;
- Vršiti ispitivanja proširenja filijala/kancelarija finansijskih institucija;
- Održava štampane i elektronske dosijee finansijskih institucija, uključujući registre ključnih lica (akcionari, direktori i viši rukovodioci), kancelarije finansijskih institucija, agente i brokere finansijskih institucija;
- Doprinosi izradi politika, procedura, priručnika za licenciranje, ostalih delegiranih propisa i uputstava finansijskih institucija;
- Podržava neophodnu saradnju sa svim relevantnim stranama Odeljenja;
- Obavlja sve druge obaveze koje su mu određene od strane rukovodioca Divizije za licenciranje i direktora OLS-a.

Potrebne kvalifikacije i iskustvo:

- Bačelor diplomu u smeru Pravni, Ekonomije, Finansija i Računovodstva;
- Da ima tri (3) godine radnog iskustva u oblasti finansija, računovodstva ili u industriji osiguranja.
- Tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika;
- Poželjno je znanje engleskog jezika.

Svi kandidati treba da dostave dole navedena dokumenta:

- Zvaničan obrazac CBK za apliciranje;
- Prateće (motivaciono) pismo gde se naglašava zainteresovanost za ovu poziciju;
- Kopije diploma, dok diplome stečene izvan Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od nadležne institucije/organizacije;
- Izveštaj iz Penzionog fonda koji dokazuje vremenski period radnog iskustva;
- Dokaz o identitetu i stalnom prebivalištu na Kosovu.

Procedura za apliciranje:

- Poslednji rok za apliciranje je **4. oktobar 2022. godine**.
- Apliciranje se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko službene internet stranice CBK -a ili putem arhive CBK -a. Nijedan drugi oblik apliciranja neće se razmatrati.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti putem službene internet stranice: www.bqk-kos.org
- **Nepotpuna dokumentacija se neće razmatrati. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju uslove konkursa.**

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Froni Market" SH.P.K. me pronar Faton Gërbeshi, Hajvali Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811858523 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Froni Market" D.O.O. sa vllasnikum Faton Gërbeshi, Hajvali Pristin, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811858523 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Froni Market" L.L.C. with owner Faton Gërbeshi, Hajvali Pristin, has come to the decision to quit its business: 811858523 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumessedetails
Abropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook


www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Maindoor" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330437592.

- Saranda Preniqi shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Edonis Gashi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. së dhjetë të shkollës së mesme profesional "Prek Jakova" Prishtinë.

- Dr. Qamile Morina shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës me nr: KO-00549-01-01.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin me qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues